



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/568

Datë: 26.12.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40 paragrafi 2 pika d, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), nenit 10, nenit 19 paragrafi 1 pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e -XIII- të mbajtur me datë: 21.12.2018 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN RAPORTIT TË PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2018

1. Miratohet Raporti nr.02/532 datë: 12.12.2018 i punës i Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2018
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi Raporti i miratuar përfshinë gjithë punën e Kuvendit të Komunës për vitin 2018.
3. Pjesë përbërëse e vendimit është edhe raporti i punës i Kuvendit për vitin 2018.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
MAPL-së
Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Brahim Morina

